

## NDARJA MADHORE DHE MAQEDO-ETNO-URBANIZIMI: RASTI “SHKUPI 2014”

*“Shkupi është kopje tokësore e kopshtit parajsor”*

Ibn Kemal (shek. XVI)

### **Nga shoqëria postjugosllave drejt asaj post-ohridase: Turbulencat si fat**

Republika e Maqedonisë (RM) është një nga shtetet e lindura pas zhbërjes së ish-Jugosllavisë, proces ky që ka shkaktuar konflikte ndëretnike dhe ndërfitare, trauma sociale, “cunamin social” dhe një tablo shumë pesimiste për të ardhmen e Ballkanit. Edhe Maqedonia, si pjesa dërrmuese e vendeve të Ballkanit, u përfshi nga konfliktualiteti makabër. Viti 2001 ishte koha që e solli shtetin deri para shpërbërjes, por ndërhyrja ndërkombëtare dhe Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MKO) hapën një faqe të re në historinë e këtij vendi, atë të kalimit nga një shoqëri politike monoetnike (1989, 1991) në një shoqëri shumëetnike, multikulturore. MKO-ja solli ndryshim të karakterit të shtetit, promovim të zhvillimit paqësor dhe harmonik të shoqërisë, duke respektuar interesat etnike dhe fetare të të gjithë qytetarëve të RM-së, përfaqësim të barabartë në të gjitha nivelet sociale të përkatësive të ndryshme. Këtë rend të ri të këtij shteti mund ta quajmë “Maqedonia postohridase” ose Maqedonia e Tretë. Ishte fryma e Ohrit që qetësoi gjakrat në fillim të mileniumit të ri, kur soteriologët presin shpëtimin, ndërsa te ne ndodhi “kriza”.

Kur flasim për shoqëritë e tranzicionit ose ato postjugosllave, zakonisht nënkuptojmë shoqëritë që ende vuajnë nga ethet e mëvetësisë, pra bëhet fjalë për shoqëri në krizë permanente, për shoqëri që kërkojnë udhën drejt stabilitetit të mirëfilltë. Maqedonia është një shoqëri multikulturore për nga struktura natyrale e

---

\* Profesor i rregullt, UEJL, Tetovë, Maqedoni.

saj, shoqëri shumëetnike, antropologjikisht shumëtrajtëshe, por që ende nuk e ka gjetur atë që quhet *common ground*, që do të mundësonte stabilizimin social. Realiteti i Maqedonisë së sotme është ai i një shoqërie të ndarë, i një shoqërie me “*etnizim të të gjitha sferave të jetesës*” (Atanasov, 2003: 141), në të cilën nacionalizmi është “*element konstituiv i veprimit dhe identitetit politik*” (Warren, 1993: 17).<sup>(1)</sup>

Republika e Maqedonisë, edhe njëzet vjet pas shpalljes së pavarësisë, dhe dhjetë vite pas konfliktit, vazhdon të mbetet peng i mikro-nacionalizmave dhe i çështjeve të pazgjidhura, i identitetit të kontestuar nga të tre fqinjët, me probleme, si ai i emrit, i gjuhës dhe kishës, marrëdhëniet maqedonase-shqiptare brenda RM-së etj. Në veçanti, çështja e emrit e mban shoqërinë në një *purgator social*, duke pamundësuar integrimet euroatlantike. Siç thotë Mathew Branwasser “*ridefinimi ambicioz i identitetit të këtij vendi të vogël, që është shprehje e veçantë ballkanike e hiperpatriotizmit, i shoqëruar me trumpetim për rrënjët antike të Maqedonisë (më mirë e thënë e maqedonasve-A.P.) gjeneron rritje të shqetësimit në përmasa ndërkombëtare lidhur me rritjen e autoritarizmit*”.<sup>(2)</sup>

Programi patriotik i qeverisë nuk gjen mbështetje te shqiptarët, të cilët përbëjnë 25 % të popullatës. Partitë shqiptare vazhdimisht proklamohen se “*antikuizimi*” i identitetit maqedonas i largon miqtë e RM-së nga Bashkimi Evropian (BE). Sipas një hulumtimi, të realizuar në maj të vitit 2010, 78 % e të anketuarve janë shprehur se raportet shqiptaro-maqedonase janë të prishura tej mase.<sup>(3)</sup> Kjo dëshmon se jetojmë në një gjendje të *multikulturalizmit patologjik*.<sup>(4)</sup>

Grupi Ndërkombëtar i Krizës (ICG), organizatë kjo joqeveritare e përkushtuar për zgjidhjen e konflikteve, në raportin e tij të shpallur në gusht të vitit 2011 thotë: “*Nacionalizmi etnik maqedonas në rritje, menaxhimi autoritar me shtetin nga Kryeministri dhe partia e tij, rënia e pavarësisë së mediave dhe gjyqësisë, ndasitë në rritje në*

<sup>1</sup> Ali Pajaziti, *Culture and the Quality of Life: The Case of Macedonia*, Logos-A, Skopje, 2011, f. 44.

<sup>2</sup><http://www.plusinfo.mk/mislenje/334/Raste-zagrizenosta-za-avtoritarizmot-vo-Makedonija/15.10.2011>

<sup>3</sup> A1, 19 maj 2010.

<sup>4</sup> Niezgodna, Marian et. al., *Culture in Transition-Transition in Culture*, Jagiellonian University: Institute of Sociology, Krakov, 2009, f. 15.

*sferën e arsimit dhe decentralizimi i ngathët i kërcënohen shtetit qytetar multietnik, siç mund të bëhet Maqedonia”.*

Eurodeputetja gjermane, Doris Pak, në një takim me anëtarët e Komisionit për Politikën e Jashtme të Parlamentit Evropian, ka theksuar se në Maqedoni po rritet nacionalizmi dhe se zhvillimet e fundit janë të rrezikshme për vendin. Doris Pak tregoi se nuk besonte se Maqedonia mund të merrte në dhjetor të vitit 2011 datën për fillimin e negociatave me Bashkimin Evropian, sidomos pas ndryshimeve të fundit në Greqi, gjë që doli e saktë. Sipas saj, *“një situatë e tillë është e rrezikshme, pasi Maqedonia vërtetë ishte në rrugë të mirë pas Marrëveshjes së Ohrit, ndërsa tani ka shumë sinjale për rritjen e nacionalizmit”* (NOA).<sup>(5)</sup>

Raporti i Komisionit Evropian (KE) i vitit 2011, vë në dukje se marrëdhëniet ndëretnike kanë qenë të ngarkuara dhe janë përcjellë me disa incidente. Këtu kontestohet edhe projekti i famshëm “Shkupi 2014”, ku ndër të tjera thuhet: *“Projekti urban “Shkupi 2014” ka krijuar tensione ndëretnike. Anëtarët e bashkësive joshumicë janë ankuar për lënie pas dore të kulturës së tyre historike”*. Ka selektim politik dhe etnik në shpërndarjen e mjeteve për zhvillimin rural dhe të mjeteve për zhvillimin e bujqësisë. Raporti i KE-së, gjithashtu vë në dukje se investimet në projekte të kulturës dhe projekte të arsimit, nuk bëhen në mënyrë të barabartë në të gjitha komunat dhe nuk reflektojnë përbërjen multietnike të shtetit.<sup>(6)</sup>

### **Shkupi autentik, bashkëjetesa e pluralizmi kulturor përkundër Shkupit artificial**

Mendimtari i shquar dhe filozofi austriak Ivan Iliç, në kuadër të ligjëratës së tij kontroverse, mes të tjerash thotë: *“Qytetin mund ta fshini nga faqja e dheut nëse ia merrni frymën”*.<sup>(7)</sup> Hermeneutika e kësaj fjalie na bën të kuptojmë se qytetet janë organizma të gjallë, me trup e me shpirt, *“me qeliza e inde”*, qenie që frymojnë, madje edhe që rebelojnë kur dikush ua merr pushtetin, janë entitete që

<sup>5</sup> Koha, 19.11.2011.

<sup>6</sup> <http://www.rdk.org.mk/lajmet-lista-rdk/215-e-verteta-mbi-raportin-e-ke-se-per-progresin-e-Maqedonisë/28.11.2011>.

<sup>7</sup> Mustafa Armağan, Şehir Asla Unutmaz, İz Yayıncılık, Stamboll, 1996, f. 15.

nuk harrojnë kurrë (M. Armagan), por që mund të pushojnë së ekzistuar nëse nuk i kultivojmë dhe nuk motivojmë kulturën. Edhe Komte i konsideronte qytetet “*organe reale*”. Që nga qytetet më të vjetra (Byblos, Damascus, Jericho) e deri më sot, bashkë me qytetet, të cilat kanë sjellë edhe qytetërimin, është zhvilluar edhe një kulturë e veçantë që e dallon dhe e veçon atë nga *geisti* rural, nga mënyra fshatare e jetesës. Kjo kulturë është mbiquajtur kulturë qytetare ose kulturë urbane, që në qytetet myslimane të Ballkanit deri para disa dekadave quhej kulturë e shehrit (shehërliut), <sup>(8)</sup> që e përditësuar del në formën *urban life* (jetë urbane).

Qyteti është formë specifike sociale dhe kulturore, është burim i marrëdhënieve të caktuara shoqërore, <sup>(9)</sup> është lokus ku shënohet dukuria e rritjes së racionalitetit. Qyteti është madhështi sociologjike dhe ekonomike, artefakt teknik, kulturologjik e antropologjik. Qyteti është hapësirë publike komplekse, është vepër artistike.

Sot, qytetet ndryshojnë shumë shpejt, <sup>(10)</sup> ato rriten dhe zgjerohen, duke ndryshuar trajtën dhe strukturën e tyre. Epoka e modernitetit qytetin e ka bërë më dinamik, e ka shpëtuar nga të qenit pre e ngushtësisë, klanizmit, e ka kozmopolitizuar, e ka bërë të hapur ndaj botës. Sot flitet për qytete nëntokësore, nëndetare, për qytete që fluturojnë në stratosferë, për qytete që tërhiqen nëpër botë si insekte monstruoze metalike. <sup>(11)</sup>

Çuditërisht, Ballkani si hapësirë e pafat e historisë, ofron edhe pamje të qyteteve të shkatërruara, qyteteve të përvuajtura, të cilat shekullin e kaluar e shënuan me tmerrin që përjetuan. Sarajeva dhe Vukovari janë shembuj të qyteteve të vdekura, të dëmtuara nga dora e njeriut. Këto qytete një herë i shkatërroi eksplozioni. Shumë qytete të vendeve në tranzicion i shkatërroi implozioni, mobiliteti masovik horizontal drejt epiqendrës, migrimi i panatyrshëm i njerëzve që kërkojnë shpëtimin në kryeqytete (p.sh. Prishtina dhe Tirana), të deformatuara nga mbipopullimi,

<sup>8</sup> Shih: Burcu Akan Ellis, *Shadow Genealogies: Memory and Identity Among Urban Muslims in Macedonia*, The American University, Washington, D.C., 2000.

<sup>9</sup> Gjyldane Mulla, *Sociologjia urbane*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2000, f. 101.

<sup>10</sup> Богдан Богдановиќ, Градот и иднината, Темплум, Шкуп, 2011, f. 13.

<sup>11</sup> Богдановиќ, f. 15.

nga rurbanizimi, që s'janë projektuar për numër kaq të madh të banorëve, që s'kanë kapacitete infrastrukturore për t'u përballur me fenomenin e rritjes së banorëve, makinave, shtëpive...

Shkupi është një vendbanim me dimension të një qyteti global, qytet në të cilin jo vetëm që kryqëzohen kultura të ndryshme dhe identitete të ndryshme etnike, por edhe qytet i paradigmave historike dhe civilizuese. Ai është një qytet me histori të bujshme të bashkëjetesës dhe të multikulturalizmit. Në fakt, kjo është vetë Maqedonia. Ajo është si një kryeqytet ku kryqëzohen rrugët, ku përplasen interesat e sunduesve dhe ku shkrihen njëra në tjetrën shumë kultura, tradita, gjuhë.<sup>12</sup> Disa Shkupin e kanë quajtur *l'ombeliuco del mondo*, kërthizë e botës, kurse Maqedoninë *catena mundi*. Një politikan e akademik turk, Davutoglu (2010), këtë vend e cilësoi si qendër dhe zemër të Ballkanit.

Shkupi, bashkë me Sarajevën (Bashçarshia), ka njërin nga çarshitë më të bukura të Ballkanit. Aty do të gjeni qeleshën e shqiptarit, kasketën e maqedonasit, shaminë e myslimanës, muzikën e bakllavanë turke, leblebixhiun torbesh, karrocierin rom. *"Deset kebapi ve molam!"* (*"Dhjetë qebapë ju lutem!"*), *"Simit pogaçë"*, *"Bujrum, bujrum!"*, *"Sa janë mollat?"*, *"Kumanovo, Kumanovo"*, *"Allahu Ekber"*, *"Allahu Ekber"* (ezani), zëri i këmbanës së kishës *"Shën Spas"*, janë pjesë e siluetës dhe teatrit të gjallë të Shkupit.

Sot, turistët ose mysafirët nga jashtë, me të hyrë në Maqedoni, marrin një mesazh në celularët e tyre që thotë: *"Mirë se erdhët në Maqedoni, në djepin e civilizimit"* (*Welcome to the cradle of civilization!*), huazim ky paraparakisht i përdorur për Egjiptin dhe Mesopotaminë. Mozaiku kulturor i quajtur Maqedoni, që veçohet me një *"diversitet të thellë"* (Taylor, 1994) është një gjendje natyrore. Ajo është një *"korridor civilizimi"* ku bashkohen Lindja me Perëndimin. Shkupi është fëmijë me dy prindër! Tashmë, në vitin 2012, kur kanë kaluar pesë dekada pas tërmetit katastrofal, Shkupi denjësisht ka ndryshuar nga utopia e Kenzo Tanges, nga një qytet i hapur drejt një qyteti të ndarë. Shkupi organik e natyral është zëvendësuar nga një tjetër, ai artificial, në Shkupin GMC (genetically modified city), i dëmshëm për shëndetin social të qytetarëve të saj. Ky qytet, ka kaluar shumë periudha, nga Skupi i Tit Livit, shekulli I p.e.s., Ûskupi osman (1392-1912), Shkupi i 1912-ës, Skopje (midis dy luftrave botërore), Skopia

<sup>12</sup> Kim Mehmeti, Shkupi, Logos-A, Shkup, 2011, f. 73.

bullgare e LDB-së dhe Skopje/Shkupi i periudhës së komunizmit dhe tranzicionit, dikur krenaria e dardanëve, sot “*qyteti i vjedhur*” (T. Osmanli),<sup>(13)</sup> i përfshirë nga deliriumi urban dhe neuroza kolektive politike, nga ideologjia e nacionalizmit aleksandrist (ndonëse në kohën e Lekës së Madh kombet s’kanë ekzistuar, kurse mobiliteti dhe pluralizmi kanë qenë mbizotërues) që po prish panoramën e këtij margaritari të Ballkanit.

### **“Shkupi 2014” si metaforë e irracionalitetit: Berlina i dytë në skenë**

Më 25 nëntor 2011, po përmbushja ritualin medial rutinor, po shikoja televizor dhe kuptova se Maqedonisë po i përgatitet edhe një projekt tjetër shumë i madh, “Maqedonia 2014”, për të cilin Partia Liberal-Demokrate reagoi ashpër. “*Homo politikusi*” i partisë në pushtet, që nga viti 2006, VMRO-DPMNE, përveçse shkaktoi ritendosje të situatës që vazhdon deri sot, gjeneroi edhe projekte identitare über-Mazedonische, si “Shkupi 2014”, një hap ky i “*transit gruevskian*” që përmes politikës së vjetëruar të identitetit<sup>(14)</sup> krijon konflikte permanente të brendshme dhe të jashtme. Në vitin 2006, një vit pas decentralizimit administrativ, partia e porsazgjedhur populiste dhe konservatore, filloi t’i ngjallë frustracionet pas konfliktit, në lidhje me identitetin dhe presionin e evropianizimit, deri në atë masë që kjo qasje mori forma vizuale urbane (“Shkupi 2014”).<sup>(15)</sup> Ky projekt ndjek vijën e identitetit monolit dhe monocentrik të profilit të dikurshëm të qyteteve evropiane, që tani në emër të skenave dhe kuptimeve të shumta është braktisur, shumëngjyrshëmëri kjo që qytetit i ofron jo vetëm larmi kulturore, por edhe potencial ekonomik. Për këtë arsye, sot, kombet e përparuara heqin dorë nga identitetet e ashpra, për shkaqë ekonomike, ashtu siç nuk munden të mbijetojnë ekonominë nacionale në epokën e globalizimit të pakompromis.

<sup>13</sup> Shih: Дејан Буѓевац et. al., Крадат град, Темплум & Плоштад Слобода, Скопје, 2010.

<sup>14</sup> Никола Гелевски, Архиторура и гробаризација, Темплум, Шкуп, 2010, f. 17, 21.

<sup>15</sup> Mijalkoviq & Urbanek, Shkupi: Bastardi i botës, Goten, Shkup, 2011, f. 76.

Shkupi përmes këtij projekti është ndarë, në Shkupin e anës së djathtë (maqedonas) dhe në atë të anës së majtë (shqiptar). Analisti Kim Mehmeti lidhur me këtë është shprehur se “*dikush dëshiron ndarje dhe mure*”.<sup>(16)</sup> Sipas tij “*...i ndarë në pjesën e tij jugore dhe veriore, Shkupi është qytet ku, ata që vetveten sot e quajnë maqedonas etnikë, ndërtojnë të kaluarën e munguar të tyre, ndërsa shqiptarët, si dhe të tjerët që sot jetojnë në këtë qytet, duan ta ruajnë me çdo kusht të sotmen e rrënjosur thellë në të shkuarën ilire të këtij qyteti*”.<sup>(17)</sup>

Pra, bëhet fjalë për një metafizikë emotive dhe identitete për përdorim politik ditor, për një konjunkturë të partisë qeveritare shamaniste. Pra, siç duket, disa harrojnë se qeniesimi në qytet dallon nga qeniesimi si pjesë e korpusit nacional.<sup>(18)</sup> Shkupi, përmes këtij *delirium tremens*, dalëngadalë po shndërrohet në qytetin më të shëmtuar të Evropës, shembëlltë e kështjës dhe e pashijes. Inferioriteti historik dhe vetëdija e prapambetur karikaturalisht kanë bërë që sheshi të shndërrohet në një vend ku farkëtohet identiteti i mbimaqedonasit ose maqedonoidit.<sup>(19)</sup>

Kritikat nga instancat ndërkombëtare vazhdojnë të vijnë në kohën kur kërkimi i identitetit po intensifikohet.<sup>(20)</sup> Qendra e qytetit është shndërruar në mishmash të statujave historike që s’korrespondojnë njëra me tjetrën (20 të mëdha dhe 100 të vogla). Në një radius të vogël, vizitorët shohin Aleksandrin e Madh të bronxtë, Justinianin, shenjtorët ortodoksë, Cirilin dhe Metodin nga shekulli IX, car Samoilin, Dame Gruevin, Goce Dellçevin e shumë të tjerë. Aty vazhdon ndërtimi i Teatrit Kombëtar, i Muzeut të Luftës Maqedonase, i Arkivit Shtetëror, i Muzeut Arkeologjik, i Gjyqit Kushtetues, i Prokurorisë dhe Policisë Financiare, i urës “Syri”...,<sup>(21)</sup> të gjitha në stilin barok, bashkë me rifasadimin e ndërtesave në sheshin “Maqedonia”. Porta Triumfale, e lartë

<sup>16</sup> <http://www.youtube.com/watch?v=2kV3N7xtBo4>

<sup>17</sup> Kim Mehmeti, Shkupi, Logos-A, Shkup, 2011, f. 28.

<sup>18</sup> Gelevski, f. 29, 41.

<sup>19</sup> Gelevski, f. 73.

<sup>20</sup> Ministri i Financave, Zoran Stavrevski në një deklaratë të tij ka thënë: “Bëhet fjalë për rindërtim të identitetit tonë. Ne mundohemi që ta ngjallim identitetin tonë të humbur gjatë komunizmit”. (Mathew Brunwasser, “Concerns Grow About Authoritarianism in Macedonia”, The New York Times, October 13, 2011).

<sup>21</sup> <http://www.youtube.com/watch?v=pOBK1vfjJwg>

22 metra, të cilën një analist e ka cilësuar si “Porta Mizeria”, që sipas sondazheve del si objekti më i urryer ndër ato të “Shkupit 2014” (R. Ramadani), në promovimin solemn të së cilës nuk mori pjesë as partia shqiptare në qeveri (BDI) e as partitë opozitare, është një nga ndërtesat e këtij projekti antiurban. Lidhur me të, një qytetar ka shtruar pyetjen se cilin triumf do të kremtojë Porta Triumfale?<sup>(22)</sup> Një tjetër qytetar që CNN-it i ka kërkuar të mbetet anonim ka thënë:

*“Tanimë mundohem që t’i shmangem sheshit të qytetit. Është shndërruar në një park argëtues (theme park). Ngado që të ktheheni gjeni statuja dhe skulptura të reja të bronxta. Sikur duan të krijojnë identitet kombëtar. S’mund të imagjinoj qytet tjetër që ndërton portë triumfale në shekullin XXI”.*<sup>(23)</sup>

Shkupi është shndërruar në Luna Park të përmendoreve,<sup>(24)</sup> në një histori në miniaturë, në një legoland, në një *neverland*, pak antik, pak Romë, pak Paris, pak Vjenë. “Expo 2014” është shndërruar në metaforë të diznifikimit, në hapësirë totale dhe historicizëm, në sintaksë postmoderne, në *buffer zone*, në hapësirë të krjimit të identitetit të ri.

Arkitekti i mirënjohur Miroslav Gërçev është shprehur se ky projekt përbën një mbetje arkitektonike, një qiç, përçartje për të cilën harxhohen 300-400 milionë euro.<sup>(25)</sup>

Ish – kryeministri i Maqedonisë, Ljupço Georgievski në një prononcim për një televizion bullgar lidhur me “Shkupin 2014”, ka thënë:

*“Qendra e Shkupit është e ngjashme me Disneylandin ose me parkun “Asteriks” në Paris. E gjithë pjesa tjetër e Maqedonisë nuk ka asnjë rrugë të rregulluar, nuk ka asnjë manifestim kulturor, bëhet fjalë për një karikaturë konceptuale*

<sup>22</sup> “The capital city gets a controversial facelift”, The Economist, August 26, 2011.

<sup>23</sup> Catriona Davies,, “Is FYROM’s capital being turned into a theme park”, CNN, October, 4, 2011

<sup>24</sup> Bogdanovic, f. 62.

<sup>25</sup> Qëndrimet zyrtare flasin për harxhime diku rreth 80 milionë euro, kurse kritikët thonë se fatura finale do të jetë diku rreth 500 milionë euro (<http://www.balkaninsight.com/en/gallery/skopje-2014>).

*të ndryshme në kryeqendrën e Republikës së Maqedonisë”.*<sup>(26)</sup>

Të gjitha këto janë përpjekje për ta bërë këtë shtet njëfetar, njënacional dhe për t’i dhënë konotacion njëkulturore, që bie ndesh me realitetin shoqëror.

*“Rikonstruktimi i planifikuar i ndërtesave reprezentative të periudhës sllave të Mbretërisë së Jugosllavisë (të viteve ‘30-të të shekullit XX) do të duhet të krijojë lidhje me qytetin evropian, të krishterë e borgjez, ndonëse Shkupi asnjëherë nuk ka qenë i tillë – dhe ta mohojë të kaluarën e tij orientale, myslimane”.*<sup>(27)</sup>

Është shumë tmerruese që e gjithë kjo strategji realizohet në mënyrë arbitrare, gjë të cilën e theksoi edhe ish-euroambasadori Fuere, sipas të cilit sikur të pyeteshin vetë Dellçevi dhe Karevi, do të kishin thënë që mos t’u vendosen shtatorët pa pyetur qytetarët.<sup>(28)</sup> Një analist tjetër në mënyrë sarkastike tha se nëse vazhdohet me këtë ritëm, R.M.-në e pret *“Bruce Lee faza”*, pra shembulli i Mostarit, ku qytetarët s’arritën të merreshin vesh për skulpturat që do të vendoseshin, dhe më në fund vendosën që ta vendosnin figurën e artistit të njohur.<sup>(29)</sup> Maqedonizimi si ideologji sllavo-ortodokse po hap krahët si një lucifer i vërtetë. Është një provokim dhe tendencë për t’i rrethuar shqiptarët dhe myslimanët në një geto dhe për t’u dhënë përshtypjen se Maqedonia dhe kisha janë një, se edhe antikiteti dhe objektet osmane pasqyrojnë ortodoksizëm.<sup>(30)</sup> Absurdi duket edhe nga fakti se synohet të ndërtohen kisha ortodokse dhe përmendore të heronjve sllavë edhe në vende ku kurrë më parë ato nuk kanë ekzistuar.<sup>(31)</sup>

Një nga regjisorët më të famshëm maqedonas, Slobodan Unkovski, flet për gjendjen e përgjithshme të Shkupit të trazuar dhe përgjegjësinë ndaj këtij entiteti të përbashkët:

*“Pas lëshimit të frymës së urrejtjes ndaj mendimit ndryshe (artikulluar edhe në procedurat e “Shkupit 2014”) dhe rrahjes*

---

<sup>26</sup> [www.albeu.com/30.01.2012](http://www.albeu.com/30.01.2012).

<sup>27</sup> Mijalković & Urbanek, f. 11.

<sup>28</sup> Alsat-M, 17 maj 2010.

<sup>29</sup> Suad Misini (Rruga drejt..., Alsat-M, 25 mars 2010).

<sup>30</sup> Pajaziti, f. 41.

<sup>31</sup> Mehmeti, f. 28.

*së studentëve në shesh, gjithçka u bë e lejuar dhe e mundshme. Këtë e treguan të gjitha ngjarjet, nga presioni, syrgjynosja, burgosja, vrasjet, protestuesit kujdestarë, mbyllja e mediaeve, përçmimi i Kuvendit, rrënimi i kapaciteteve të dobëta të vendit, thirrja për linçim, harxhimi jotransparent i parave tona, zhvillimi i ndjenjës së pasigurisë individuale”.*

Historia e Shkupit (pse jo edhe e Maqedonisë, sepse ky kancer është i përhapur në gjithë vendin) lidhet edhe me periudhën nën okupimin e nacionalizmit agresiv, të *barok-burek nacionalizmit*. Regjisori thotë se s’është dashur që Shkupin t’ia dorëzojmë dragoit barok, pa u munduar ta mbrojmë atë, pa u munduar t’i ndihmojmë të shpëtojë nga ky invazion primitiv i pashijes dhe arbitraritetit, arkitekturës diletante dhe simbolikës patetike dhe kuazipatriotizmit të rikomponuar.<sup>(32)</sup>

Qëndrim mosaprovues lidhur me këtë projekt ka edhe faktori ndërkombëtar, nga politikanët e deri te mediat. *The Wall Street Journal*, lidhur me “Shkupin 2014”, ka vënë një titull “*A Face-Lift in Macedonia*”, duke kritikuar populizmin gruevskian, duke potencuar se ky projekt urban ripërtëritës shtyn krenarinë kombëtare të maqedonasve, por trazon kontroversat kulturore dhe politike.<sup>(33)</sup> Një analist tjetër thotë se ky projekt shkakton grindje jo vetëm brenda Maqedonisë, por edhe jashtë saj, me vendet fqinje (Greqia e merr për provokativ këtë projekt, Bullgaria disa figura të sheshit të Shkupit i ka nëpër qytetet e veta). Sipas tij, është e pakuptimtë që gjithë këto para të harxhohen në një kohë kur 1/3 e popullatës jeton në vijën e varfërisë.<sup>(34)</sup> “The New York Times”, në tetor të vitit të kaluar, ka vënë një titull përmes të cilit e përshkruan kështu gjendjen: “*Shtohen shqetësimet lidhur me aoritarizmin në Maqedoni*”.<sup>(35)</sup> Një kroat, lidhur me manifestimin e 20-vjetorit të pavarësisë përreth “*kalorësit antik*” ka dhënë cilësimin “*Cirk nën kalin e Aleksandrit*”, duke e krahasuar Gruevskin me diktatorët

<sup>32</sup> Utrinski Vesnik, 14.02.2012.

<sup>33</sup> “The capital city gets a controversial facelift”, *The Economist*, August 26, 2011.

<sup>34</sup> Erhan Turbedar, “Skopje 2014, Not Just An Urban Project”, <http://www.trt.net.tr/International/newsDetail.aspx?HaberKodu=48545f9a-77f2-47e3-8044-70a75df95653/retrieved on March 20, 2012>.

<sup>35</sup> Brunwasser, op.cit.

postsovjetikë si Nazarbajev dhe Turkmenbashë, kurse fjalimin e tij me atë të Çavezit.<sup>(36)</sup>

Gazetari i njohur turk Akif Emre, në një artikull të tij të titulluar *“Komb-ndërtimi në atelienë e idhujve”*, ka shënuar se kombet ballkanase janë formësuar edhe si reaksion ndaj kombit osman, kurse *“Shkupin 2014”* e ka cilësuar si refleksion të kësaj filozofie antiosmane që përçmon dhe përjashton *“tjetrin”* (myslimanin). Për Emren, statujat e sheshit *“Maqedonia”* janë *“monumente të shëmtisë”*.<sup>(37)</sup>

Gazeta holandeze *“De Volkskrant”* në një speciale të 2 janarit 2015 ka ironizuar ndërtesën e re të rikonstruktuar të qeverisë në stilin barok (prapa fasadave ka një objekt modern që daton nga vitet ‘70-të të shekullit të kaluar dhe që ishte ndërtuar me shumë çelik dhe xhama), por të veshur me materiale gipsi, duke e krahasuar atë me Shtëpinë e Bardhë, kur thotë se për të parë këtë shtëpi nuk keni nevojë të kaloni oqeanë, por mjafton të udhëtoni në Shkup, në kryeqytetin e Maqedonisë.

*“Për dallim nga Shtëpia e Bardhë në Uashington, shtëpia e bardhë maqedonase ka fasada gipsi. Është çështje kohe se kur do të fillojnë të shfaqen plasaritjet dhe sërisht të shihet pamja e brishtë e ndërtesës. Kjo nuk dallon nga demokracia e këtij vendi. Shikuar nga jashtë, në këtë vend në letër kemi zgjedhje dhe shteti mundëson të gjitha liritë, por nëse hidhni një shikim pas fasadës do të shihni se qeveria e akuzuar për keqpërdorim të fuqisë së saj, në çdo hap është e akuzuar se nuk respekton rregullat demokratike”, shkruan gazeta “De Volkskrant”.*

Damir Nikshiq, i diplomuar në Akademinë e Arteve Figurative në Sarajevë, Milano dhe Bolonjë, me master nga Universiteti i Arizonës, një kohë edhe profesor vizitor në Universitetin e Masaçusetsit, që në NNS (metatezë e CNN-it) e vuri në vatër këtë projekt, duke e krahasuar barokun shkupian me atë të Meksiko Sittit, të aplikuar nga francezët. Ai mjeshtërisht e satirizon *“Shkupin hibrid”* *“Bobo, ç’u paska ndërtuar Shkupi!”* Lart, mbi një shtyllë, një engjëll, e *“poshtë me gjasë ferri”*. Porta e Brandenburgut!

<sup>36</sup> <http://www.tportal.hr/vijesti/svijet/147500/Cirkus-pod-Aleksandrovim-konjem.htm>

<sup>37</sup> Yeni Şafak, 18 mars 2014.

Ky është shekulli XIX dhe Porta Triumfale, e mbiquajtur edhe si “*Porta mizeria*”. Shtatore gjithandej, devalvim i statujave. “*Nëse s’keni bërë asgjë, lirisht mund të shpresoni se mund t’ju bëjnë një përmendore në Shkup*”. Paris i vërtetë! Vinçat... “*Kudo që të shohësh hapësirë të lirë, mbill nga një skulpturë*”. Kjo është filozofia urbane e *kiçit* të surrealizmit gruevskian. Mos vallë edhe peshkatarit i kanë bërë skulpturë? “*Jo njeri i vërtetë, i gjallë qenka*”, konstaton boshnjaku. Kuarti i bankave. *Wallstreet*-i i Shkupit... Shtatoret para Ministrisë së Jashtme, veshje qytetare. “*Vetëm këtu kjo veshje quhet ashtu, ndonëse është veshje pariziane, vjeneze*”... Kolona doriane, korintiane, joniane. Antikë. Këtë s’mund ta gjesht askund në botë. Kur t’i bashkosh të gjitha këto përmendore, do t’i nxjerrësh në shitje publike; nëse s’ka vlerë artistike, do ketë tregtare. Galera romake (a bizantine) në Vardarin e verës 50-70 cm të thellë, madje edhe *simulacrum* me peshkaqenë.<sup>(38)</sup>

Kjo është pasqyra që regjisorin e njohur V. Zhilnik e ka shtyrë që këtë projekt ta quajë tragjikomedi të tranzicionit, kurse *Associated Press-in* që Shkupin (2014) ta cilësojë si “*kiç-kryeqyteti i Ballkanit*”.

Ideja dhe utopia e ideatorit të Shkupit të pastërmetit (1963), japonezit Kenzo Tange, ishte qyteti i hapur, racional, egalitar (UN, 1963), si qytet i urave fleksibël të aparatit të qytetëruar<sup>(39)</sup> kurse sot lindin ndërtesa-mure që ndajnë këtë kryeqytet në atë të bregut të majtë dhe të djathtë, në atë jugor dhe verior, që të kujtojnë Berlinin e dikurshëm që mbetet simbol i qyteteve të ndara dhe jofunksionale.

## Konkluzione

Shkupi përbën një nga qendrat më të rëndësishme historike, kulturore dhe politike të Ballkanit. Qytetari i arsyeshëm i Republikës së Maqedonisë së këtyre ditëve konstaton se sa më tepër që rritet maqedonizimi i Shkupit aq më tepër shtohet ndasia e qytetit dhe shoqërisë në përgjithësi. Tani sheshi i kryeqytetit nuk është zonë e relaksit, por e tendosjes, e nxemjes së situatës. Çdo jomaqedonas që kapërcen atypari kaplohet nga ndjenjat e

<sup>38</sup> Ali Pajaziti, “Shkupi 2014”: Berlini i Dytë dhe parodia boshnjake, tesheshi.com, 20 korrik, 2015.

<sup>39</sup> Mijallkoviç & Urbanek, f. 28.

indiferentizmit dhe pezmit ndaj qeverisë që këtë qytet e ka dyzuar, e ka ndarë në dy pjesë, në “tonin” dhe “të tyrin”. Kjo formë e urbanizimit nacional ose e etnourbanizimit të përshkruar me kicë e shëndërrndon pamjen e këtij qyteti, të cilit dëshirohet t’i jepen ngjyrimet të barokut ose të klasicizmit. Ne nuk u besojmë tezave se *“Ballkani është arë ku nuk mbin fara e shteteve shumëtnike, se në këto hapësira, vështirë merren vesh edhe përfaqësuesit politikë me të njëjtën përkatësi etnike, e le më ata që i ndan gjuha, religjioni dhe e kaluara”*, dhe shpresojmë në genin pozitiv të antroposit, pa marrë parasysh gjeografinë.

Shkupi është qytet të cilit dikush mundohet t’ia vjedhë të kaluarën. Momentalisht, po ndodh tendenca për deshqiatarizim dhe deislamizim të Shkupit. Me këtë kurs, Republika e Maqedonisë s’ka një ardhmëri të shëndoshë, kur amza e qyteteve përjeton një thyerje, një proces të hendekhapjes ndërnacionale. Shkupi nuk është Shkup nëse ka dy pamje: urban dhe ai rurban, njëri më, ndriçim, godina shumëkatëshe, salla dhe objekte kulturore, dhe tjetri, qytet i mjerimit, i karrakatinave të Gazibabës, Seravës e Dizhonit, i teneqemëhallave dhe i sokaqeve të ngushta, si ato të njëres nga komunat me dendësi më të lartë në Evropë (në Çair 18.400 banorë jetojnë në një kilometër katror).<sup>(40)</sup> Në këtë klimë, maqedonasit, gjithnjë e më rrallë e kalojnë Urën e Gurit që ta vizitojnë pjesën “shqiptare” të Shkupit.<sup>(41)</sup> Këtij qyteti, i mbiquajtur “Skupimetropolis” (Marcelin Komes), dita – ditës po i humbet identiteti nga populizmi dhe obsesioni imperial, që gjeneron vetëm përplasje, siç ishin ato të marsit 2012. Sociologjikisht dhe arkitekturalisht, projekti i estetikës nacionaliste del i dëmshëm për kohezionin e një shoqërie shumëkulturore siç është Republika e Maqedonisë. Shoqërinë civile dhe inteligjenca kanë qenë aktive në korrektimin e politikave autoritare, në vetëdijesimin e qytetarëve për reperkusionet e hapave të pamatura. Ndërkohë nuk kanë munguar as reagimet e faktorëve eksterne (ndërkombëtarët) për të ruajtur multikulturalizmin e kësaj shoqërie që përballet me dhimbjet e kalimit në fazën posttranzicionale. Dhe si pasojë e diktaturës iliberale dhe e dhunës pamore, populli reagoi në mënyrë demokratike, në dhjetor të vitit 2016, e drejtoi votën

<sup>40</sup> <http://www.cair.gov.mk/index.php?topmenuitem=Popullsia>

<sup>41</sup> Mehmeti, f. 39.